

## Znj. Mine Cuka

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, të depozituar pranë ISSH-së me nr./prot. 531, dt: 25.01.2021, sqarojmë se:

Për pyetjen: - *Në bazë të ditelindjes time (01.07.1961), kur mund ta bëj kërkesën për përfitim pensioni pleqërisë?*

- Në ligjin 7703, dt: 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 31, pika 1 është përcaktuar se:  
*1. Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji.*

Referuar nenit 92, ju që jeni e datëlindjes 01.07.1961, ju lind e drejta për përfitim (aplikim) pensioni pleqërie në dt: 01.11.2022, në moshën 61.4 muaj. Për të përfituar pension pleqërie me vjetërsi të plotë në punë duhet të keni 37 vite e 8 muaj vjetërsi në punë.

Për pyetjen: - *Pas miratimit të ligjit nr.160/2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore” a i ka filluar efektet një ligj i tillë dhe a njihen automatikisht vitet e kooperatives dhe kur ka mangësi vertetimete?*

- Ligji nr.160/2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”, ka për qëllim njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore, për të cilat është djegur dokumentacioni arkivor i vjetërsisë në punë, deri në hyrjen në fuqi të ligjit 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", i ndryshuar. Ky ligj është miratuar në dt: 23.12.2020 dhe për momentin nuk ka hyrë në zbatim pasi janë duke u përgatitur aktet nën-ligjore për zbatimin e tij.

Për pyetjen: - *Kërkesa për pension bëhet vetëm on-line në portalin e-albania apo edhe fizikisht në institucion sepse kam paqartësi?*

- Aplikimi për pension pleqërie bëhet vetëm on-line, në portalin e-albania, tek shërbimi "Aplikim për pension pleqërie, suplementar pilot, suplementar lundruar i nëndetëseve apo suplementar për akademik", ndërsa dokumentat origjinale që aplikuesi i bashkëlidh aplikimit dërgohen me postë në adresë të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore perkatëse.

Nëse aplikuesi e ka të pamundur ta realizojë aplikimin on-line për përfitim pensioni, mund të paraqitet në zyrat e ADISA-s ose të Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore pranë vendbanimit, për të aplikuar nën asistencën e specialisteve.